



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3033/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit “Riinvest”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Administratë Publike, MA 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
 - Shkenca e të Dhënave dhe Analiza e Biznesit, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Nuk akreditohen programet e studimit të Kolegjit “Riinvest”:
 - Dizajn, BA 180 ECTS.
 - Menaxhimi i Hotelerisë, Niveli V, 120 ECTS
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji “Riinvest” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji “Riinvest” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Administratë Publike, MA 120 ECTS Akreditim	Arben Qirezi Ariana Qosaj-Mustafa
2	Shkenca e të Dhënave dhe Analiza e Biznesit, MSc, 120 ECTS Akreditim	Bernard Nikaj Melinda Pacolli
3	Dizajn, BA 180 ECTS Akreditim	Yll Rugova Albana Muja Astrit Desku Neshat Shala Zana Nixha
4	Menaxhimi i Hotelerisë, Niveli V, 120 ECTS Akreditim	Uragan Alija Diana Lekaj Etnike Dibrani

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin “Riinvest”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 31.03.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Vedran Đulabić, Marko Komšo, Damir Kalpić, Diana Milčić dhe Dražen Vrhovski.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Administratë Publike, MA, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht një (1), pjesërisht dy (2).
2. Për programin e studimit Shkenca e të Dhënave dhe Analiza e Biznesit, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht dy (2) dhe nuk e përmbush një (1).
3. Për programin e studimit Dizajn, BA 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht dy (2), pjesërisht katër (4) dhe nuk e përmbush një (1).
4. Për programin e studimit Menaxhimi i Hotelerisë, Niveli V, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht një (1) dhe pjesërisht gjashtë (6).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit "Riinvest" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Riinvest";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

